



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

V E N D I M

NR. 35 DATË 10.05.2013

**PËR RIVLERËSIMIN E STUDIMIT TË PLANIT RREGULLUES TË PARKUT
KOMBËTAR TË DAJTIT, MIRATUAR ME VENDIMIN E K.RR.T.R.SH NR. 9, DATË
06.04.1994, DHE LEJE ZHVILLIMORE KOMPLEKSE PËR NDËRTIMIN E
HAPËSIRAVE DHE MJEDISEVE REKREATIVE BIO-KLIMATIKE, MALI I DAJTIT,
QARKU TIRANË**

Në mbështetje të nenit 8, nenit 50, nenit 70/8 dhe nenit 70/11 të Ligjit nr. 10119 datë 23.04.2009 "Për Planifikimin e Territorit", i ndryshuar, dhe Vendimit nr. 87 datë 07.02.2012 të Këshillit të Ministrave "Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit", Këshilli Kombëtar i Territorit

V E N D O S I :

1. Të miratohet rivlerësimi i studimit të planit rregullues të parkut kombëtar të Dajtit, miratuar me Vendimin e K.RR.T.R.SH. nr. 9, datë 06.04.1994, dhe leja zhvillimore komplekse për ndërtimin e hapësirave dhe mjediseve rekreative bio-klimatike, mali i Dajtit, qarku Tiranë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

SALI BERISHA

ZËVENDËS KRYETAR I KKT

SOKOL OLLDASHI

MINISTËR I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT



SEKRETARE E KKT

KREUZA LEKA

DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

A handwritten signature in blue ink, appearing to be "Kreuz Leka".